



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	27.04.2021
Referenc-ë:	07-353/04-72430/21
Për/ Za/ To:	“QIPS”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën nga Qendra për Informim dhe Përmirësim Social me të cilën kërkohet që me datë 3,4 dhe 5 Maj 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike „Sheshi Zahir Pajaziti” nga ora 10:00 deri në 17:00

Qëllimi i aktivitetit është përkrahja e projektit “Linja e jetës” (qendër telefonike për parandalimin e vetëvrasjeve) e cila punon vullnetarisht dhe u përgjigjet telefonatave të personave që kanë mendime për vetëvrasje me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie. Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin “Zahir Pajaziti” me datën 3,4 dhe 5 Maj 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

28.04.2021

Faqe 1 nga 1